



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, mbajtur më 31.10.2022, duke filluar në orën 14:00.

Në mbledhje morën pjesë: Valbona Ajeti (AAK), kryesuese, Gresa Lahu (PDK), Endrit Zabërgja (NISMA) dhe Adelina Mehiu, eksperte e jashtme.

Në mbledhje mungoi: Rita Zeqiri (VV).

Të pranishëm ishin edhe: Arta Balaj, drejtore e Drejtorisë së Kulturës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Valbona Ajeti**, kryesuese e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Për mbledhje propozoi këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport;
2. Diskutim rreth Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Kulturës;
3. Projekti ideor i tunelit të kurrizit;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Faqe nga 4

Valbona Ajeti, kryesuese, tha se në bazë të kërkesës së drejtoreshës së Kulturës, do të vazhdojmë njëherë me pikën e Projektit ideor të tunelit të Kurrizit, pastaj me diskutimin rreth Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Kulturës.

Arta Balaj, drejtoreshë, i njoftojë anëtarët e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, rreth procedurave të tenderimit të projektit deri në zgjedhjen e kompanisë fituese, pastaj me të gjitha planet dhe ndryshimet se çka është paraparë në këtë projekt, si p.sh. tavanet dhe muret të shndërrohen në vepra artistike, në mënyrë vizuale, projektit të ventilimit, shtegut për biçikleta, trotuareve etj. Pastaj është paraparë që trafiku gjatë ditëve të javës të jetë njëkahor, gjatë vikendeve kur edhe kemi aktivitete kulturore, të jetë i mbyllur.

Ne ende nuk e dimë koston sa sa do të kushtojë ky projekt ideor, por e kemi themeluar komisionin, i cili do të merret me të gjitha këto probleme dhe specifikat të cilat i përmendëm.

Gresa Lahu, tha se pjesa e kurrizit ku edhe planifikohet projekti, ka pasur nevoja të mëdha dhe emergjente për rregullimin dhe sanimin e këtyre problemve, si për banorët ashtu edhe për lokalet dhe bizneset të cilat veprojnë në atë pjesë, duke filluar nga platoja, ventilimi, pastaj kanalizimi, mbeturinat e kështu me radhë.

Arta Balaj, drejtoreshë, tha se tani mund ta shohim projektin e planit ideor të Kurrizit, të përgatitur nga kompania, pastaj ta komentojmë dhe analizojmë së bashku. Ajo tha se do të kemi dëgjime publike prapë me banorët e lagjes "Dardania", do të diskutojmë me ju, me asamblistë të tjerë në Kuvend, pastaj të ulemi së bashku me kryetarin, nënkryetarët dhe menaxhuesit e projektit të shohim format, zgjedhjen sa më të mirë dhe më të përshtatshme për atë pjesë.

Endrit Zgabërgja, tha se sa i përket projektit, për mua po duket shumë mirë dhe besoj se kjo do të jetë shumë shpejt ndoshta edhe një simbol i ri i kryeqytetit. Po ashtu, do të jetë një ndër punët kryesore të kësaj qeverie gjatë këtij mandati. Po e presim planin finalizues ideor, i cili po shpresojë se do të jetë një zgjidhje për të gjithë, si për banorët, bizneset, po edhe për neve si banorë të kryeqytetit. Do ta keni përkrahjen tonë të plotë.

Pika e tretë

Diskutim rreth Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Kulturës.

Arta Balaj, drejtoreshë, rreth diskutimit të kësaj rregulloreje, tha se së pari do të shohim harmonizimin e Rregulloreve, në mes asaj të nivelit lokal dhe qendror, pastaj kategorizimi i ndarjes se shumave të subvencioneve për individë dhe për biznese, ndalimin e aplikimit për zyrtarët e Komunës, formulimi i shablloneve rreth poentimit të aplikantëve për subvencione, definimi i qartë i shpenzimeve të pranueshme dhe të papranueshme, rregullimi i caktimit të mandatit të komisionit të ankesave në harmonizim me dy rregulloret e lartpërmendura. Në komisionet për vlerësim kisha pasur dëshirë që të marrin pjesë edhe anëtarët e Komitetit për Kulturë, së paku në rolin e mbikëqyrësit.

Faqe2nga4

Ajo shprehu mendimin se duhet të jetë obligative paraqitja e secilit individ, biznesi apo OJQ-je, që aplikon, të na informojë rreth asaj se a ka aplikuar diku tjetër, apo a ka mbështetje nga ndonjë insticion tjetër. Një formë të një deklaratë nën betim, apo diçka të ngjashme, në mënyrë që t'u mundësojmë edhe atyre që nuk financohen nga orgaizatat e tjera. Këtë vit, në marrëveshje edhe me Zyrën ligjore, kemi vendosur që personat të cilët nuk e përfundojnë raportin e finalizimit të projektit, do të përcillen te përmabaruesi dhe kështu do ta bëjmë shprapësimin e atyre mjeteve.

Endrit Zabërgja tha se do të ishte mirë që të kemi qasje edhe te aktivitetet kulturore, pra te secili kalendar i aktivitetit që parashihet të mbahet edhe nga ne si Komitet, por gjithësesi ju si Drejtori e Kulturës, në mënyrë që të jemi sa më shumë të informuar rreth këtyre aktiviteteve.

Arta Balaj, drejtoreshë, tha se ne jemi duke punuar për këtë kalendar të punës, i cili po shpresojmë se do të ketë të dhëna për të gjitha aktivitetet të cilat do të mbahen në Kryeqytet, si p.sh. emri i aktivitetit, lokacioni, data dhe ora, çmimi për hyrje, vendi ku mund të blihen biletat për çfarëdo lloj aktiviteti që mbahet, qoftë art, teatër, balet, kinema, muzikë etj. Ne do ta mbushim këtë kalendar me më shumë të dhëna rreth aktiviteteve dhe, posa të jetë i gatshëm do t'ua përcjellim edhe juve ta shikoni.

Endrit Zabërgja, tha se tavani për subvencione duhet të ekzistojë, sepse nuk mund të trajtohen njëjtë individit dhe organizata. Pastaj ai tha se mbështes shabllonin rreth poentimit, ndalimin e aplikimit të zyrtarëve të Komunës në subvencione, klasifikimi i pagesave në subvencione. Besoj se duhet të ketë një organ mbikëqyrës për implementimin dhe përzgjedhjen e përfituesve. Po ashtu, komisioni i ankesave të jetë sa më funksional në kthimin e përgjigjeve brenda afateve ligjore.

Arta Balaj, drejtoreshë, tha se anëtarët e komisioneve përzgjedhëse të subvencioneve zgjidhen nga zyrat e Drejtorisë së Kulturës, por pastaj për listat e subvencioneve dhe raportimin e kanë për detyrë ta bëjnë te Kryetarit.

Pika e katërt Të ndryshme

Arta Balaj, drejtoreshë, i njoftoi anëtarët e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport rreth projekteve të festave të fundvitit, duke filluar nga festat e Nëntorit. Ne si drejtori i kemi të ndara rreth 70 mijë euro për këto projekte, por ende nuk kemi diçka përfundimtare nga niveli qendror se a do të kemi mundësi ta bëjmë dekorimin e sheshit me drita për shkak të shpenzimeve elektrike. Jemi në bisedime dhe besoj se shumë shpejt do ta marrim një përgjigje përfundimtare për këtë. Pastaj e kemi edhe Maratonen e babadimrave, e cila është një ide shumë e bukur. Ne kemi biseduar me organizatorin dhe jemi dakorduar që kjo të mbahet atë ditë kur të bëhet edhe ndezja e ndriçimit në shesh. Jemi duke shikuar mundësitë e kampshpëtzave në shesh, si ajo që ka qenë "Verë n'Dimër", dhe koncertin e fundvitit.

Sa i përketë Qendrës Kulturore në Llukar, e kam inicuar si procedurë, duke menduar se projekti ka qenë i përfunduar, por pastaj kur kemi kontraktuar me kompaninë, ka dalë se nuk janë të parapara disa gjëra. Ideja ime ka qenë që atë buxhet ne ta shfrytëzojmë edhe mos t'i humbasim. Jemi duke kontaktuar me kompaninë që së paku t'i përfundojë disa punë elementare, por ende nuk kemi asgjë konkrete.

Ajo tha se shumë shpejt do ta bëjmë përzgjedhjen e operatorit ekonomik për shkollën e vjetër "Mehmet Kaquri", ndërsa sa i përket "Parkut të aventurave", kemi nënshkruar një marrveshje me Swiss Kontaktin, ku kemi deklaruar se si projekt do ta inicojmë prapë, por kësaj radhe jo në parkun e Gërmisë, por afër Parkut të Arinjëve, edhe pse ende nuk është përfundimtare.

Mbledhja përfundoi në orën 16:15.

Procesmbajtësi
Arton Brahim

Kryesuesja e mbledhjes së komitetit
Valbona Ajeti



Faqe4nga4